



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 928 Date 4.12 2007

PËR DEPOZITIMIN E STATUTIT TË  
SH.A. "UJËSJELLËS" FSHAT LUSHNJË

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1. Depozitimin e statutit te ndryshuar te shoqërisë Sh.A. "Ujësjiellës" Fshat Lushnjë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



# STATUTI I SHOQERISE ANONIME

## NENI 1

### Emertimi dhe selia

Shoqeria Anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes Shtetërore "Ujesjelles Fshat" Lushnje. Shoqeria e krijuar në këtë mënyrë emërohet: "Ujesjelles Fshat" Sh..A Lushnje. Selia e Shoqërisë është në adresë : Lushnje.

## NENI 2

### Objekti i shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

Furnizimi me ujë të pishëm në 10 Komuna përfshirë edhe Poshnjën e Beratit. Komunitat janë: Fierëshegan, Allkaj, Krutjë, Bubullimë, Kolonjë, Gradishtë, Remas, Grabjan, dhe Lushnje.

Produktimi dhe shitja e ujë në 36 fshatra, Fierëshegan, Barbullinj, Kocaj, Cukas, Ura e kucit, Hinka, Allkaj Toshkez, Delisufaj, Zhelizhan, Mazhaj, Ngurez, Gur, Remas, Karavastae re, Kamenice, Adriatik, Mucias, Ferras, Gradishtë, Babunjë, Gungas, Gramsh, Sulzotaj, Bicakaj, Cukas i ri, Lifaj i ri + Kamçisht, Pirre, Rrapëz Sektor, Rrapëz fshat, Gorre, Bishqethem, dhe Shakull.

Shoqëria brenda çfaqëve të parashikuara nga legjislativimi në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera jashtë vendit.

## NENI 3

### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 66.422.000 leke. Numri i aksioneve është 66.422. Vlera nominale e aksionit është 1000 leke. Në kapitalin themeltar nuk është përfshirë vlera e truallit, gjë e cila do të bëhet në një kohë të dytë.

## NENI 4

## Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi.

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi do te kryhet me Urdher te Ministrimit te Ekonomise , ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin .

### NENI 5

#### Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- 1) Keshilli Mbiqyres
- 2) Drejtoria

### NENI 6

#### Keshilli Mbikqyres

- Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 ( tre ) anetare . Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise.
- Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 ( kater ) vjet . Anetare e keshillit mbikqyres jane te gjitha te rizgjedhshem . Ata mund te revokohen nga titullari iorganit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike . Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri
- Ne se nje, ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje , shkarkimi ose doreheqje , zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 ( tre) muaj Anetari i e keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesimin te nje anetari tjetere , perfundon mandatin e paraardhesit.
- Anetare e keshillit mbikqyres te moshes 65 ( gjashtedhete e pese) vjec nuk mund te jene me shume se 1/3 ( nje e treta ) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

### NENI 7

#### Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli Mbikqyre zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillit dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjitha kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem Keshilli Mbkiqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij Ne rat mungese ose pengimi te kryetarit , mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari .

## NENI 8

### Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres m blidhet sa here e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit , ose ne mungese te tij te zvedeskryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 ( pesembedhjete ) diteve kur drejtoria ose 1/3 ( nje e treta ) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim . Nese kerkesa mbetet pa pergjigje atehere anetaret duhet te therrasin mbledhjen e keshillit mbikqyres , duke percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet

3 ( tre) dite perpara , me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat nese anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate.

Cdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshme vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem , ne rast barazimi votash , ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjese marrjes ne mbledhjen e tij i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje..Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi. , nga kryetari ose zevendes kryetari

Kopjot e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendes kryetari i keshillit mbikqyres.

## NENI 9

### Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli Mbikqyres emerone drejtorine. Keshilli cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise
- Keshilli Mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te ketij statuti.
- Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje ne cdo kohe verifikime dhe kontrole qe ai i cmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.

- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj . Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli
- Keshilli Mbikqyres i propozon Ministrin te Ekonomise lidhur me keto ceshtje :

- a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter afat mesem dhe afat gjate te shoqerise
- b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- c) Hapja e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
- d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
- e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera
- f) Marrjen e huave afatmesme dhe afatgjate.
- g) Si dhe cdo gje tjeter qe ne baze te Ligjit 'Per shoqerite tregtare » eshte kompetence e Asamblese se Pergjitheshme

#### NENI 10

##### Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne Vendim te Keshillit te Ministrave .

#### NENI 11

##### Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria , e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakort jo me pak se 2/3 ( dy te tretat) e te gjithe anetareve te ketij keshilli.  
Anetaret e drejtorise jane persona fizike , ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem .Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri . Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise manadati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar i drejtorise ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te emerohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura . Ne rastin kur i ineresuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine , shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe 4( kater) vjetesh . Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.

- Anetare e drejtorise jane te riemerueshem , ata nuk mund te jene mbi moshen 65 vjec. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 vjec konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre .

#### NENI 12

##### Kompetencat e drejtorise.

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te drejtorise.
- Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruarar nga anetari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin veprimtarise se shoqerise , pervec rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke patur paarsysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme .
- Akte me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e anetareve te saj . Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2(dy) vjet dhe me vlere mbi 2(dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- Marredheniet brenda shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres
- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise , te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

#### NENI 13

##### Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetareve te drejtorise ose nje anetari te keshillit mbikqyres qofte e drejteperdrejt ose jo e drejteperdrejt duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Percaktimi i mesiperme eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter , kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte dhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i ineresuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesa e ketij neni te statutit. Anetari i ineresuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14  
Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrrolli i shoqerise ushtroiht nga 1, ( nje ) ekspert kontabel i autorizuar i cili emerohet nga aksionmbajtasi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin .

NENI 15  
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te odo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga date e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me date 31 dhjetor .

NENI 16  
Inventari -llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit.

Rezulati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem . Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar kur eshte rasti me humbjet e meparshme , hiqet te pakten 5% ( pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme, kur kjo rezerve arrin ne 1/10 ( nje te dhjeten) e kapitalit themeltar Ajo rifillon per nje aresye cfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen ne 1/10 ( nje te dhjeten) e kapitalit  
Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te „Ministrit te Ekonomise

NENI 18

Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres.

Si anetar te pare te keshillit mbikqyres.:

Z. Skender Hasa.

Z. Agim Akulli

Zj. Dhurata Xhaxhiu

NENI 19

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Eksperti i ( te ) pare i ( te ) autorizuar emerohet ( n ) :

Zj. Laureta Filipi

NENI 20

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut , ushtrohen nga Ministri i Ekonomise me cilesine e aksionerit te vetem .

NENI 21


Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6 ( gjashte) muajsh nga data e rr egjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar drejtori i shoqerise do te jete drejtor i sh ndermarrjes shteterore  
Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise vec per shkaqe te perligjura.

NENI 22

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

Arben MALAJ  
MINISTER







REPUBLIKA E SHQIPERISE

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE TE SH.A "UJESJELLES FSHAT LUSHNJE"

VENDIM

NR. 1 DATE 15/05/2014

Asambleja e Aksionereve te sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje" ne mbledhjen e saj te dates 15/04/2014, si dhe ne mbeshtetje te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 135, pika 2/b, Asambleja e Aksionereve,

VENDOSI

1. Te miratoj statutin e sh.a "Ujesjelles-Fshat Lushnje".
2. Ky vendim shpallet ne daten 15/05/2014.

AKSIONERET:

*Novin Jeto*  
  
*Ujesjelles*  
  
*Ergest Gjovani*  


*Ashut*  
  
*Stambolli*  
  
*Shamir*  
  
*Agim*  


**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE " UJESJELLES FSHAT LUSHNJE " SHA**

Shoqeria " UJESJELLES FSHAT LUSHNJE " SHA ka fituar personalitet juridik me Vendimin Nr. 30611, date 27.11.2003, te Gjykates se Rrethit Tirane me NIPT K44222401J. Aksioneret e shoqerise deklarojne se ne vazhdimesi veprimtaria e shoqerise " UJESJELLES FSHAT LUSHNJE " SHA, do te rregullohet, organizohet dhe zhvillohet ne baze kerkesave te Ligjit, Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**KREU I**  
**Aksioneret, forma, emri, selia, vula, kohezgjatja.**  
**Neni 1**  
**Aksioneret**

Aksioneret e shoqerise jane:

1. Aksioner	Komuna Libofsh
Kontributet e zotëruara	6.412,00
Përqindja e pjesëmarrjes	9,99
2. Aksioner	Komuna Poshnje/Berat
Kontributet e zotëruara	6.220,00
Përqindja e pjesëmarrjes	9,70
3. Aksioner	Komuna Gradisht
Kontributet e zotëruara	6.540,00
Përqindja e pjesëmarrjes	10,19
4. Aksioner	Komuna Krutje
Kontributet e zotëruara	6.284,00
Përqindja e pjesëmarrjes	9,80
5. Aksioner	Komuna Remas
Kontributet e zotëruara	3.975,00
Përqindja e pjesëmarrjes	6,19
6. Aksioner	Komuna Terbuf
Kontributet e zotëruara	9.234,00
Përqindja e pjesëmarrjes	14,40
7. Aksioner	Komuna Dushk
Kontributet e zotëruara	6.797,00
Përqindja e pjesëmarrjes	10,60
8. Aksioner	Komuna Kolonje

	Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	5.066,00 7,90
9. Aksioner	Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Komuna Fier Shegan 5.514,00 8,59
10. Aksioner	Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Komuna Bubullime 4.360,00 6,79
11. Aksioner	Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Komuna Allkaj 3.719,00 5,79

**Neni 2**  
**Forma**

Shoqëria " UJESJELLES FSHAT LUSHNJE " SHA është e organizuar dhe funksionon në formën e një Shoqërie Aksionare. Statuti bashkëlidhur është ndryshuar në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 3**  
**Emri**

Emri i shoqërisë është "UJESJELLES FSHAT LUSHNJE" SH.A.

**Neni 4**  
**Selia**

4.1 Selia e shoqërisë "UJESJELLES FSHAT LUSHNJE" SHA është në Republikën e Shqipërisë në adresën: Lagjja "Skender Libohova"

4.2 Shoqëria mund të krijojë degë, përfaqësi ose agjensi të tjera në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj...

**Neni 5**  
**Vula**

Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrimin:  
Shoqëria " UJESJELLES FSHAT LUSHNJE"

**Neni 6**  
**Kohezgjatja**

Veprimtaria e shoqërisë do të vazhdojë për një periudhë kohe të pakufizuar.

**Neni 7**  
**Objekti i veprimtarise**

7.1 Furnizim me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitje e tij. Mirembajtjen e sistemeve te furnizimit me uje te pishem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve.

7.2 Per te permbushur objektin e veprimtarise, ( pa pretenduar qe ky te jete aktiviteti kryesor i saj), shoqeria mund te marre pjese ne ndermarrje apo shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te perafert me te sajin dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter te luajtshem e te paluajtshem, te pranoje dhe te leshoje garanci per vete apo per te trete, te marre kredi dhe te kryej cdo operacion bankar, konforme legjislacionit ne fuqi.

7.3 Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo valuta te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, konform legjislacionit ne fuqi.

7.4 Per permbushjen e objektit te veprimtarise, Shoqeria mund te punesoje me kohe te plote ose te pjesshme profesioniste te mirenjohur nga fusha te ndryshme, konforme legjislacionit ne fuqi.

7.5 Objekti i veprimtarise se shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**KREU II**  
**Kapitali Themeltar**  
**Neni 8**

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 64.121.000 leke.

8.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 64.121 aksione me vlerë nominative 1.000 lekë secili. Aksionet janë të pandashme.

8.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe është shlyer plotësisht nga aksionaret e shoqërisë.

8.4 Me kerkesen e aksionarit te interesuar dhe me shpenzimet e tij, Shoqëria eshte e detyruar te lëshoje certifikatën qe verteton zoterimin e aksioneve. Vendimi për lëshimin e certifikatës merret nga asambleja e pergjithshme.

**KREU III**  
**TREGETIMI (TRANSFERIMI) I AKSIONEVE**  
**Neni 9**

Aksionet jane te tregtueshme vetem pas regjistrimit te shoqërisë ne Rregjistrin Tregtar. Ne rastet e zmadhimit te kapitalit aksionet jane te tregtueshme, pas depozitimit te ndryshimeve perkatese ne Rregjistrin Tregtar. Aksionet mbeten te tregtueshme edhe pas prishjes se shoqërisë e deri ne perfundim te procesit te likuidimit.

Me perjashtim te rasteve te trashëgimise, transferimi i aksioneve tek te tretet behet me miratimin e tre të katërtave e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, në përputhje me procedurën qe vijon:

Aksioneri qe kërkon te transferoje aksionet e tij tek te tretet, tërësisht apo pjesërisht, është i detyruar qe fillimisht t'i rezervoje aksionereve te tjerë te drejtën e parablerjes. Për te lejuar ushtrimin e kësaj te drejte, aksioneri qe dëshiron te transferoje kuotën e tij duhet te lajmëroje me shkrim (me letër-rekomandë) gjithë aksioneret qe figurojnë ne Regjistrin e aksioneve (ne shtëpinë e secilit, me adresat qe rezultojnë ne këtë Regjister), duke e specifikuar çmimin e shitjes, mënyrën e pagesës dhe emrat e blerësve te mundshëm.

Nëse njoftimi nuk i arrin marrësit, ajo do te konsiderohet e mbërritur nga te dy palët ne datën kur postieri konfirmon datën e dorëzimit me adresën e përcaktuar ne këtë Regjister.

Përgjigja e ofertës për te ushtruar te drejtën e parablerjes duhet t'i kthehet aksionerit ofertues, me shkrim (me letër-rekomandë), brenda 30 ditëve, nga data qe ortaku (ose ortaket) e interesuar kanë marre njoftimin për ofertën e shitjes.

Ne rast se asambleja refuzon (me shkrim) dhënien e miratimit, aksioneret brenda tre muajve nga data e refuzimit, janë te detyruar te blejnë aksionet e ofruara nga aksioneri ofertues, me te njëjtin çmim dhe me te njëjtën mënyre likuidimi qe aksioneri ofertues ka vendosur ne njoftim.

Ne rast se asnjeri nga aksioneret ne veçanti apo asambleja ne përgjithësi nuk përgjigjen brenda 3 (tre) muajve, (nga data e njoftimit te ofertës), miratimi i transferimit konsiderohet i dhëne dhe aksioneri ofertues, është i lire t'i transferoje aksionet e tij tek te tretet.

E drejta e parablerjes ne transferimin e aksioneve nominative i takon aksionereve te tjere te shoqerise, sipas radhes se paraqitjes se ofertes dhe ne rast te paraqitjes se menje-hereshme, i takon Keshillit Mbikqyrës, te vendose percaktimin e radhes.

Keshilli Mbikqyrës cakton bleresin brenda 3 (tre) muajve, nga data e paraqitjes se ofertes per transferim te aksioneve.

Ne rast se brenda kesaj periudhe nuk caktohet bleresi, aksioneri ka te drejte t'i shese aksionet e tij (ose nje pjese te tyre) cdo bleresi te zgjedhur prej tij (person fizik ose juridik), me cmim te lire, por jo me te ulet se cmimi i ofruar aksionareve.

Ne te gjitha rastet kur aksionet nominative i transferohen te treteve, eshte e detyrueshme qe ne regjistrat e shoqerise te behen ndryshimet perkatese ku duhet te shenohen ne vecanti:

- a) Data e operacinit (data e transferimit te aksioneve);
- b) Emrat mbiemrat dhe adresat e banimit te titullarit te vjeter dhe atij te ri;
- c) Vleren nominative dhe numrin e aksioneve te transferuara;

**KREU IV**  
**DREJTIMI I SHOQERISE**  
**ADMINISTRATORET**

**Neni 10**

**Administratoret dhe kontrolli mbi te.**

Shoqeria administrohet nga nje administrator. Administratori i ushtron funksionet e tij nen kontrollin e Keshillit Mbikqyrës.

**Neni 11**

### Emerimi dhe shkarkimi

Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Keshilli i Mbikqyres. Kontraten e punes me Administratorin e neneshkruan ne emer te Shoqerise, Kryetari i Keshillit Mbikqyres, ose nje nga anetaret e autorizuar nga Keshilli Mbikqyres. Ne Kontraten e Punes, caktohet edhe shperblimi i Administratorit.

### Neni 12

#### Kohezgjatja e mandatit

Administratori emerohet per nje periudhe 3 (tre) vjeçare dhe mund te riemerohet.

### Neni 13

#### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise brenda objektit te veprimtarise se shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ia jep shprehimisht Keshillit Mbikqyrës dhe Asamblese se Pergjithshme Administratori shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve te caktuara ne Statut.

Administratori perfaqson shoqerine

a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;

b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare para te treteve, ne gjykata, arbitrazhe, disponon pasurine dhe interesat e saj, me perjashtim te kompetencave qe u takojne organeve te tjera te shoqerise.

c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;

d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

e) të raportojnë përpara këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Per kryrjen e Veprimeve juridike ne emer te shoqerise, eshte i domosdoshem, vendimi i Keshillit Mbikqyrës.

Administratorit nuk i lejohet te kontraktoje ne cfardolloj menyre qofte, te marrin hua tek shoqeria, te jape pelqimin ne emer te saj per paradhenie, si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj (shoqerise) angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Administratorit nuk i lejohet te kryejë veprimtari konkurruese dhe as te marre pjese ne subjekte te tjera konkurruese si ortak, i punesuar apo funksionar, qofte edhe pa shperblim.

Administratori pergjigjet individualisht ndaj shoqerise ose te treteve, per shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Klauzolat e Statutit qe kufizojne kompetencat e Administratorit, duhet te respektohen nga te tretet. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur provon se te tretet e dinin se akti i Administratorit i tejkalon kompetencat e tij, apo objektin e veprimtarise se shoqerise.

Rregullat e ketij neni nuk zbatohen per marreveshjet qe behen per operacionet e perditshme dhe te kryera ne kushte normale.

Vendimet e Administratorit protokollohen.

## KESHILLI I MBIKQYRES

### Neni 14

### Kompetencat

**Keshilli i Mbikqyres ka keto kompetenca:**

- a) Keshilli Mbikqyres emerohet dhe shkarkohet Administratorin e shoqerise me 2/3 e votave te anetareve te tij.
- b) te japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- c) te kontrollojë e te mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
- ç) te përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe te zbatojë vendimet e asamblesë;
- d) te thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- dh) te kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- e) te shqyrtojë e te kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- ë) te sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit Mbikqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit Mbikqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- f) te sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit Mbikqyrës, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- g) te emërojë dhe te shkarkojë administratorin, të ndajë kompetencat per të;
- h) te përcaktojë shpërblimin e administratorit;
- j) te miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet



- nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- l) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- m) të miratojë strukturën administrative të shoqërise, kriteret e punesimit dhe të pagave si dhe rregulloren e brendshme të shoqërise.
- n) të vendosë për dhenien e dorezanive dhe të garancive.
- o) të vendosë për kryerjen e investimeve tej atyre të parashikuara në programin financiar vjetor.
- p) të vendosë për hapjen, mbylljen apo ndryshimin e sektoreve të ri (brenda objektit të veprimtarisë së shoqërise).
- q) Autorizon miratimin, negocimin, përfundimin apo ndryshimin e veprimeve juridike që lidhen me shoqërine.
- r) të kryejë të gjitha verifikimet dhe kontrollet që ai cmon të arsyeshme dhe kërkon të njihet me dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e detyrës së tij.
- s) të paktën një herë në 3 (tre) muaj të thërrasë në Raport Administratorin.
- t) të miratojë rradhën e transferimit të aksioneve, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 8 paragraf 4 dhe 5 të Statutit.

#### Neni 15

#### Emerimi, Perberja, mandati i anetareve

Keshilli Mbikqyrës përbehet prej 6 (gjashtë) anetaresh të cilet zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

Perberja e Keshillit Mbikqyrës është si më poshtë:

1. Alvin Gjata e bijai e Lulzim dtl. 04.07.1986 banues në adresën Barbullinjë, Lushnjë mbajetes i leternjoftimit nr. 160709114I
2. Ferdinant Dushi i biri i Miti, dtl. 06.08.1968 banues në adresën Lushnjë mbajetes i leternjoftimit nr. G80806014P
3. Agim Akulli i biri i Miti, dtl. 28.08.1969 banues në adresën Lushnjë, mbajetes i leternjoftimit nr. G90826135R
4. Artur Narvishe e bijai e Ardulla dtl. 28.03.1972 banues në adresën Tërbuf, Lushnjë mbajetes i leternjoftimit nr. H20328112A
5. Hazis Selca i biri i Miftar, dtl. 08.03.1963 banues në adresën Kolonjë, Lushnjë mbajetes i leternjoftimit nr. G30308090G

6. Fatos: Hoxha i biri i ACI, dtl 20.04.1963, banues ne adresen Lushnje, mbajetes i leternjoftimit nr. G30 42 01 22 T

Kohezgjatja e funksionit te anetareve te Keshillit Keshillit Mbikqyrës eshte 3 (tre) vjet. Anetaret e Keshillit Keshillit Mbikqyrës, kane te drejte te rizgjidhen. Ata mund te shkarkohen ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme. Keshilli Mbikeqyres perbehet nga 6 anetare te cilet nuk mund te jene te punesuar ne shoqerine " Ujesjelles Fshat SH.A Lushnje" dhe zgjidhen me rotacion ne baze te perqindjeve te aksioneve nga aksionari me perqindje me te larte tek aksionari me perqindje me te ulet.

#### Neni 16 Zgjedhja e Kryetarit

Keshilli Mbikqyres, zgjedh nga gjiri i tij Kryetarin, i cili ngarkohet me mbledhjen e Keshillit dhe drejton debatin gjate seancave. Vendimet e Keshillit Mbikeqyres pasqyrohen ne proces verbalin e mbledhjes qe mbahet nga sekretari i Keshillit Mbikeqyres. Vendimet e Keshillit Mbikeqyres duhet te nenshkruhen nga anetaret pjesemarres ne mbledhje

#### Neni 17 Kuorumi dhe shumica per marrjen e vendimit

Vendimet e keshillit Mbikqyres vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.

#### KREU V ASAMBLEJA E PERGJITHSHME Neni 18

Asambleja e Pergjithshme eshte mbledhja e pergjitheshme e aksionareve, ne te cilen kane te drejte te marrin pjese te gjithe aksionaret, pavarsisht nga numri i aksioneve qe zoterojne.

Asambleja e Pergjithshme, ka keto kompetenca:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të keshillit Mbikqyrës dhe skemës së shpërblimeve per to;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar

dhe skemës së shpërblimeve për to;

d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

dh) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

e) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

ë) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

f) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

i) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

Për kryerjen e operacioneve të mesipërme Asambleja e Përgjithshme, procedon konform dispozitave të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në rastin e pikave "b", "gj", "e", "dh" Vendimet e Asamblese së Përgjithshme janë të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht dhe vendosin me tre të katërtat e votave të aksionarëve, pjesëmarrës në votim.

Në rastet e tjera Vendimet e Asamblese së Përgjithshme janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote dhe merret vendim me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

#### Neni 19

#### Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme

1-Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme thirret nga Keshilli Mbikqyres ose nga Administratori.

2. Nga aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Mbledhjet e Asamblese së përgjithshme mbahen në seline të shoqërisë dhe duhet të mbledhet të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme duhet të thirret domosdoshmërisht në këto raste:

a) nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

b) kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

#### Neni 20

#### Menyra e thirrjes

Thirrja e mbledhjeve te Asamblese se pergjithshme behet me leter rekomande me lajmerim marrje me shpenzimet e shoqerise.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionareve apo te njihet prej tyre te pakten 21 dite perpara mbledhjes.

Ne njoftim percaktohet:

a) emrin e shoqerise, seline e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;

b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:

i) të drejtat e aksionarëve;

ii) procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;

iii) procedurat për votimin;

c) informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet;

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të percaktuara, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 21

#### Percaktimi i rendit te dites

Rendi i dites i mbledhjeve te asamblese se pergjithshme percaktohet nga autori i lajmerimit dhe duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

Megjithate, nje apo disa aksionere qe perfaqesojne te pakten 5 perqind te kapitalit kane te drejte te fusin ne rendin e dites nje ose disa projektvendime, te cilat dergohen ne seline e shoqerise me shkrese percjellese se bashku me dokumentacionin qe verteton zoterimin apo perfaqesimin e pjeses se kapitalit prej 5% te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Keto projektvendime duhet te njofothen aksionerev te tjere jo me vone se 8 dite perpara mbledhjes.

Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Asambleja nuk mund te shqyrtoje nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites. Megjithate ajo mund te shkarkoje nje apo disa anetare te Keshillit Mbikqyrës dhe te procedoje per zevendesimin e tyre ne cdo rrethane.

Rendi i dites i mbledhjes se asamblese nuk mund te ndryshoje ne mbledhjen e dyte.

#### Neni 22

#### Perfaqesimi i nje aksionari

Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë

Cdo aksionar mund te marre kompetencat qe i japin aksionaret e tjere, me qellim qe ti perfaqesoje ata ne mbledhjen e nje asambleje pa kufizime te tjera, pervec atyre qe rrjedhin nga kufizimet ligjore apo nga Statuti, duke percaktuar numrin maksimal te votave qe mund te zoteroje i njejt person qofte ne emer te tij, qofte si mandatmbajtes.

Administratorët dhe anëtarët e këshillit Mbikqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

### Neni 23

#### E drejta e votes dhe menyra e votimit

Çdo aksion mbarat të drejtën e një vote.

Asambleja e përgjithshme merr vendimet, nëpërmjet votimit të hapur.

Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit Mbikqyrës vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionaret, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

### Neni 24

#### Perjashtimi nga votimi

Aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës edhe në rastet kur aksionari përfaqësohet me autorizim. nëse asambleja e përgjithshme duhet të marrë vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

### Neni 25

#### Anetaret e Organeve Drejtuese dhe eksp.kontab.te autor.

#### ( E drejta e pjesmarrjes )

Anetaret e Keshillit Mbikqyrës, Administratorët dhe ekspertët kontabel të autorizuar, mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e asamblese së përgjithshme pa të drejtë vote.

Ata duhet të njoftohen me shkrim brenda afatit të percaktuar në nenin 20 të Statutit. Ata gezojnë të drejtën e votes vetëm kur e zotërojnë ato me cilesinë e aksionareve.

### Neni 26

### Evidentimi i pjesmarrjes dhe P/Verbali

Ne cdo mbledhje te asamblese plotesohet nje evidence pjesmarrjeje. Te gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.

Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme dhe duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

### KREU VI NDRYSHIMI I KAPITALIT TE REGJISTRUAR Neni 27

Ndryshimi i kapitalit themeltar behet sipas TITULLIT V dhe TITULLIT VI (nenet 168 – 186) te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

### KREU VII KONTROLLI I SHOQERISE AKSONARE Neni 28

Ne shoqeri kontrolli ushtrohet nga nje ekspert kontabel i autorizuar. Emerimi i ekspertit kontabel te autorizuar behet nga Asambleja e Pergjithshme per nje vit financiar.

### Neni 29 Detyrat e ekspertit kontabel te autorizuar.

Garanton qe llogarite vjetore jane te rregullta dhe te hartuara me sinqeritet konform ligjeve.

Pasqyron rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen financiare te trashegimise se shoqerise ne fund te vitit financiar dhe sigurojne qe eshte rrespektuar barazia ndermjet aksionareve.

Verifikon librat e llogarive dhe fondet e shoqerise dhe kontrollon pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.

Verifikon perputhjen me llogarine vjetore te informacioneve te dhena nga Administratoria perpara mbledhjes se asamblese se pergjithshme dhe dokumentat mbi gjendjen financiare qe i jane paraqitur kesaj te fundit.

Eksperti kontabel i autorizuar eshte i detyruar ti beje te njohur Administratorise dhe Keshillit Keshillit Mbikqyrës:

- a) Kontrollat dhe verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet qe kane bere;
- b) Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit qe duhen ndryshuar dhe sygjerone metodat per perpilimin e ketyre dokumentave;
- c) Parregullsitet dhe pasaktesitet qe kane zbuluar;

d) Perfundimet qe rrjedhin nga korigjimi i pasaktesive te mesiperme, mbi rezultatet financiare te shoqerise.

Eksperti kontabel i autorizuar thirret ne te gjitha mbledhjet e Keshillit te Mbikqyrës si dhe ne mbledhjet e asamblese se pergjithshme.

Eksperti kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvleftesimet ne ushtrimin e funksionit perrkatese.

## **KREU VIII RAPORTET VJETORE**

### **Neni 30**

Dokumentat qe vihen ne dispozicion te Eksperteve Kontabel te Autorizuar

Ne mbyllje te cdo viti financiar Keshilli Mbikqyrës ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin. Bilancit i bashkalidhen:

1. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria.
2. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria.

Raporti i administrimit pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara te saj, veprimtarite e rendesishme qe jane zhvilluar gjate periudhes nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne daten ne te cilen eshte hartuar ky raport.

Dokumentat e permendura me siper, vihen ne dispozicion te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, te cilet thirren ne seline e shoqerise, per te miratuar llogarite e shoqerise, te pakten nje muaj perpara mbledhjes se asamblese.

### **Neni 31**

#### **Rezerva ligjore**

Shoqeria, nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi jane zbritur humbjet e vitit te meparshem, eshte e detyruar te lere menjane nje shume me vlere te pakten 5% e tij (fitimit) e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve te quajtur "Rezerve e domosdoshme".

Dispozita e mesiperme nuk eshte e detyrueshme kur "Rezerva ligjore" arrin 10% e kapitalit te regjistruar.

### **Neni 32**

#### **Fitimi qe do te shperndahet**

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, nga i cili eshte zbritur "Rezerva ligjore" sipas Nenit 32 te Statutit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose shtuar humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

Asambleja mund te marre vendim per shperndarjen e shumave te lena menjane per rezerven, me kusht qe te mos preket "Rezerva ligjore" ne masen e parashikuar ne Nenin 32 te Statutit. Vendimi tregon shprehimisht llojin e rezerves ku jane marre keto shuma. Pervec rasteve te zvoglimit te kapitalit themeltar, asnje shperndarje nuk mund t'u behet aksionareve neqoftese kapitalet e tyre jane ose do te beheshin mbas kesaj

shperndarje, me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus "Rezerven e domosdoshme", te percaktuar ne Statut.

### Neni 33

#### Percaktimi i dividendeve

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te shumes qe do te shperndahet, asambleja percakton pjesen qe i takon cdo aksionari ne forme dividendesh.

Shoqeria ka te drejte te jape edhe paradhenie, vlera e te cilave ka rrijedhur nga vitet financiare te mbyllura ose ne vazhdim, vlera keto te derdhura para mbylljes se vitit financiar, me kusht qe:

- a) Te mos preket "Rezerva ligjore";
- b) Shuma qe ka depozituar shoqeria si rezerve, te jete te pakten e barabarte me paradheniet e shperndara;
- c) Te perpilohet nje raport nga eksperti kontabel, i cili konfirmon se fitimet neto te realizuara deri ne ato kohe jane me te medha se paradheniet e shperndara.

Shperndarja e paradhenieve vendoset nga Keshilli Mbikqyrës. Ne vendim percaktohet shuma dhe data e kthimit.

### Neni 34

#### Reklamimi i Dividenteve

Shoqeria nuk mund t'u kerkoje aksionareve asnje reklamim dividendesh, me perjashtim te rastit kur plotesohen te dy kushtet e meposhtme:

- a) Shperndarja e dividendeve eshte bere ne kundërshtim me rregullat e percaktuara nga nenet 33 dhe 34 te Statutit;
- b) Kur vertetohet se perfituesit kishin dijeni per karakterin e parregullt te kesaj shperndarjeje ose kur ata (perfituesit) ne rrethanat konkrete nuk mund te mos e merrnin parasysht kete parregullsi.

## KREU IX

### PAVLEFSHMERITE DHE PRISHJA E SHOQERISE

#### Neni 35

##### Prishja e shoqerise

Shoqëria aksionare priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim gjykate;

#### Neni 36



### Likuidimi

Procesi i likuidimit kryhet ne perputhje me PJESEN VI (nenet 190 – 205) te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

### Neni 37

### ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Menyra e zgjidhjes se mosmarreveshjeve qe eshte parashikuar ne kontraten e themelimit eshte e zbatueshme edhe per mosmarreveshjet qe burojne nga zbatimimi apo interpretimi i Statutit.

### Neni 38

Ky Statut perpilohet ne 4 (kater) kopje te barazveshme nga te cilat nje kopje origjinale do te depozitohet tek noteri, nje kopje prane Regjistri Tregetar Tirane dhe dy kopjet e tjera mbeten prene selise se shoqerise.

### AKSIONERET E SHOQERISE “UJESJELLES FSHAT LUSHNIE” sha.

Komuna Poshnje/Berat  
Perfaqesuar nga ..

*M. Poshnje*  
*M. Berati*

Komuna Gradisht  
Perfaqesuar nga ..

*Ylli Stambolliu*  
*Y. Stambolliu*

Komuna Remas  
Perfaqesuar nga ..

Komuna Libofsh  
Perfaqesuar nga ..

*Hayri Doko*

Komuna Krutje  
Perfaqesuar nga ..

*Alija*  
*A. Krutje*


Komuna Terbuf  
Perfaqesuar nga ..

*Abdul*  
*A. Terbuf*

Komuna Dushkë  
Perfaqesuar nga ..



Komuna Fier Shegan  
Perfaqesuar nga ..



Komuna Allkaj  
Perfaqesuar nga ..

Egëst Gjordeni



Komuna Kolonje  
Perfaqesuar nga ..

Komuna Bubullime  
Perfaqesuar nga ..